

20101182288

L I G J
PËR NGARKIM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM PLOTËSUES TË PROJEKTIT
PËR KADASTËR TË PATUNDSHMËRIVE DHE REGJISTRIM

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore me hua në shumë prej 9 000 000 eurosh, të dedikuar për realizimin e financimit plotësues të Projektit për kadastër të patundshmërive dhe regjistrim.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për financim plotësues të Projektit për kadastër të patundshmërive dhe regjistrim, i cili do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 25 vite, me grejs-periodhë të përfshirë prej tetë vitesh.

Shkalla e kamatës është LIBOR gjashtë mujor me shtrirje të ndryshueshme (për valutën euro).

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore provizion në mënyrë të njëhershme në shumë prej 0,25 % nga shuma e huas.

Huaja do të paguhet në 34 këste gjysmëvjetore, në çdo 15 mars dhe 15 shtator të vitit. Nga 15 shtatori 2018 deri më 15 shtator 2034 do të paguhet 33 këste gjysmëvjetore në shumë prej 2,94 % nga shuma e huas, ndërsa më 15 mars 2035 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 2,98 % nga shuma e huas.

Neni 4

Shfrytëzuesit e mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji janë Agjencia për Kadastër të Patundshmërive dhe Ministria e Financave - Drejtoria për Punë Pronësore-Juridike.

Neni 5

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".